



Funded by
the European Union



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

dpak DREKTORIA
E PËRGJITHSHME
E ANTIKORRUPSIONIT

MANUALI

PËR ZBATIMIN, MONITORIMIN DHE
RAPORTIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR
KORRUPSIONIT



Funded by
the European Union



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

dpak DREJTORIA
E PËRGJITHSHME
E ANTIKORRUPSIONIT

Tiranë, Shkurt 2026

Manuali për Zbatim, Monitorimin dhe Raportimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, është hartuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Manuali është një dokument pune për institucionet që aktualisht zbatojnë Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024 – 2030.

Dokumenti është përgatitur me asistencën teknike të projektit EU4GG të Bashkimit Evropian, në kuadër të përpjekjeve për forcimin e integritetit institucional dhe llogaridhënies, në përputhje me standardet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit në vendet e Bashkimit Evropian.

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
PËRKUFIZIMI I TERMAVE	5
KUADRI RREGULLATOR PËR ZBATIMIN, MONITORIMIN DHE RAPORTIMIN E STRATEGJISË	6
I. AUTORITETET DHE FUNKSIONET ME KOMPETENCA ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT	7
1) Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe <u>Antikorrupsionin</u>	8
2) Ekipi Tematik <u>Antikorrupsion</u>	9
3) Drejtoria e Përgjithshme e <u>Antikorrupsionit</u>	10
4) Institucionet zbatuese të Strategjisë <u>Ndërsektoriale Kundër Korruptionit</u>	11
4.1 Pikat e Kontaktit <u>Antikorrupsion</u>	12
4.2 Ekipi Tematik Teknik <u>Antikorrupsion</u>	13
4.3 Strukturat e brendshme tekniko-profesionale të institucioneve zbatuese të strategjisë...13	
II. ZBATIMI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT	15
1) Informimi dhe vënia në dijeni e institucioneve për miratimin e kuadrit strategjik kundër korruptionit	16
2) Identifikimi i masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit dhe treguesve të <u>performancës</u>	17
3) Planifikimi i zbatimit në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme të <u>Antikorrupsionit</u>	18
4) Koordinimi nga Drejtoria e Përgjithshme e <u>Antikorrupsionit</u> në nivel institucional	20
5) Mbështetje nga Drejtoria e Përgjithshme e <u>Antikorrupsionit</u> dhe institucionet zbatuese...21	
III. MONITORIMI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT	22
1) Organizimi i procesit të monitorimit	23
2) Si funksionon procesi i monitorimit?	24
3) Roli i institucioneve dhe strukturave të përfshira në monitorim.....	25
4) Instrumentet që përdoren në monitorim	26
5) Afatet e monitorimit	27
IV. RAPORTIMI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT	27
1) Raportimi nga institucionet zbatuese	28
2) Raportimi nga Drejtoria e Përgjithshme e <u>Antikorrupsionit</u>	29
3) Llojet e raporteve të zbatimit të kuadrit strategjik kundër korruptionit.....	29
V. ANEKSET: FORMATE STANDARD TË ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE TË RAPORTEVE TË MONITORIMIT.....	31

Lista e shkurtimeve

APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPAK	Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit
EU4GG	Bashkimi Evropian për Qeverisjen e Mirë
GRECO	Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KDIMDHP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit
SIPI/IPSIS	Sistemi i Informacionit të Planifikimit të Integruar
SPAK	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
UNCAC	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit

HYRJJE

Manuali për Zbatimin, Monitorimin dhe Raportimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (në vijim “**Manuali**”) shërben si dokument pune për standardizimin e mënyrës se si institucionet zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030 (në vijim “**Strategjia**”), planifikojnë, zbatojnë, monitorojnë dhe raportojnë angazhimet e tyre, përmes Pikave të Kontaktit Antikorrupsion.

Manuali siguron një praktikë të unifikuar pune, rrit cilësinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave të raportuara si dhe mbështet institucionet në përmbushjen në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga Plani i Veprimit në zbatim të Strategjisë dhe nga Pasaporta e Treguesve të Performancës. Ai ofron orientime të qarta mbi proceset e punës dhe bashkërendimin institucional me qëllim zbatimin sa më eficient të Strategjisë dhe respektimin e afateve të parashikuara.

Manuali mbështetet në parashikimet e pjesës IV të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030: *Zbatimi, Llogaridhënia dhe Koordinimi*¹, si dhe në metodologjinë² e raportimit të integruar përmes Sistemit të Informacionit të Planifikimit të Integruar (IPSIS), i administruar nga Zyra e Kryeministrit.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, drejton dhe koordinon procesin e zbatimit dhe përdorimit të Manualit. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ushtron funksionin e sekretariatit teknik dhe ka rol kyç në planifikimin e zbatimit, koordinimin e veprimeve institucionale, monitorimin dhe analizimin e progresit, si dhe në përgatitjen e raporteve të monitorimit dhe raportimin e kuadrit strategjik kundër korrupsionit. Përmes këtij roli, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit siguron funksionimin e unifikuar të mekanizmave të zbatimit të Strategjisë, ofron orientim metodologjik dhe mbështetje teknike për institucionet zbatuese, si dhe bashkërendon në mënyrë të drejtpërdrejtë punën e Pikave të Kontaktit Antikorrupsion, përgjatë të gjitha fazave të zbatimit, monitorimit dhe raportimit të Strategjisë.

Për të lehtësuar përdorimin praktik të tij, Manuali përfshin anekse me formatet standarde të planifikimit, monitorimit dhe raportimit, të cilat do të përdoren nga të gjitha institucionet për zbatimin e Strategjisë.

¹ Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2025.

² Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)” (FZ 66/2020).

Në këtë kuadër, Manuali paraqet hapat konkretë të organizimit të punës, rolet dhe përgjegjësitë institucionale, si dhe procedurat që ndiqen gjatë gjithë periudhës të zbatimit, monitorimit dhe raportimit të Strategjisë.

PËRKUFIZIMI I TERMAVE

Në këtë Manual përdoren disa terma kryesorë që lidhen me zbatimin, monitorimin dhe raportimin e Strategjisë. Këta terma përdoren sipas kuptimit që u jepet në kuadrin strategjik kundër korrupsionit në fuqi dhe synojnë të lehtësojnë njohjen dhe zbatimin e saktë të këtij Manuali.

Kuadri Strategjik Kundër Korrupsionit

- Nënkupton paketën e dokumentave strategjike (Strategji, Plani i Veprimit, Pasaporta e Treguesve) të miratuar nga Këshilli i Ministrave, që përcakton objektivat, prioritetet, angazhimet dhe mekanizmat për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të tyre.

Plani i Veprimit Antikorrupsion

- Është dokumenti shoqërues i Strategjisë (Aneksi 1 bashkëlidhur saj) që përcakton masat dhe aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave strategjike, institucionet zbatuese, afatet e zbatimit, si dhe shërben si bazë për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të strategjisë.

Pasaporta e Treguesve të Performancës

- Është dokumenti shoqërues i Strategjisë (Aneksi 2 bashkëlidhur saj) që përmbledh treguesit e performancës të Strategjisë, vlerat bazë dhe vlerat e synuara për secilin tregues, si dhe shërben si instrument referimi për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e progresit të zbatimit të strategjisë.

Masë - Aktivitet - Vlerë e Synuar e Treguesit të Performancës

- Masë - është ndërhyrja e planifikuar e Strategjisë, e përcaktuar në Planin e Veprimit, që synon arritjen e rezultateve të pritshme përmes zbatimit të aktiviteteve konkrete.
- Aktivitet - është veprimi konkret që zbatohet në kuadër të një mase, i përcaktuar në Planin e Veprimit, dhe që çon në realizimin e rezultateve të pritshme.
- Vlerë e synuar - është niveli i përcaktuar që duhet të arrihet për një tregues të performancës brenda një afati të caktuar dhe që përdoret për vlerësimin e progresit të zbatimit të Strategjisë.

KUADRI RREGULLATOR PËR ZBATIMIN, MONITORIMIN DHE RAPORTIMIN E STRATEGJISË

Ky Manual bazohet në kuadrin rregullator dhe strategjik në fuqi, që rregullon hartimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e Strategjisë, si dhe funksionimin e instrumenteve të integritetit dhe mekanizmave kundër korrupsionit në administratën publike.

Kuadri rregullator strategjik

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit 2024 - 2026 në zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)”

Urdhër i Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”

Ligje që rregullojnë instrumentet të integritetit dhe mekanizma kundër korrupsionit

Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”

Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar

Ligji nr. 96/2025, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar

I. AUTORITETET DHE FUNKSIONET ME KOMPETENCA ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Manuali përcakton rregullat, proceset dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj.

Në këtë kuadër, një zbatim i mirë i Strategjisë mbështetet në një organizim të qartë rolesh dhe funksionesh, të ndara ndërmjet organeve politike, strukturave koordinuese dhe njësive teknike përgjegjëse. Përcaktimi i kompetencave të tyre synon të sigurojë koherencë në vendimmarrje, koordinim ndërinstitucional dhe ndarje të qartë të përgjegjësisë përgjatë fazave të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të Strategjisë.

Më poshtë paraqiten autoritetet kompetente dhe zbatuese të Strategjisë³:

1) Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është autoriteti politik përgjegjës për drejtimin strategjik të procesit të zbatimit të Strategjisë. Në këtë cilësi, Ministri i Shtetit ushtron funksionin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit⁴, me qëllim sinergjizimin e punës së institucioneve të ekzekutivit në raport me politikant antikorrupsion të qeverisë dhe zbatimin e të gjitha zotimeve, në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies.

Në rolin e tij si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin siguron funksionimin efektiv të mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional, nxit bashkëpunimin mes institucioneve përgjegjëse dhe të atyre me përgjegjësi të veçanta në fushën e antikorrupsionit, si dhe garanton që zbatimi i masave të Strategjisë të përputhet me objektivat kombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e luftës kundër korrupsionit.

Në cilësinë e ministrit përgjegjës për drejtimin dhe bashkërendimin e punës për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin siguron drejtimin

³ Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 është kuadri strategjik në fuqi.

⁴ Në përputhje me parashikimin e bërë në Strategjinë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2024-2030 (Pjesa IV).

e nevojshëm strategjik dhe institucional për zbatimin efektiv, të koordinuar dhe të matshëm të Strategjisë.

Në mënyrë të veçantë, Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit:

- udhëheq dhe mbikëqyr zbatimin politik të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit në zbatim;
- siguron koordinimin ndërinstucional dhe mbështetjen e institucioneve zbatuese për realizimin e detyrimeve dhe angazhimeve që burojnë nga Strategjia;
- orienton prioritetet kombëtare në fushën e parandalimit, ndëshkimit dhe ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit;
- mbikëqyr dhe drejton punën e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si sekretariat teknik përgjegjës për procesin e zbatimit, monitorimit dhe përgatitjen e raporteve të monitorimit;
- paraqet progresin, sfidat dhe rekomandimet për përmirësim në forume ndërministrorë, në Qeveri, në Kuvend dhe në mekanizmat ndërkombëtarë ku Shqipëria informon dhe raporton;
- garanton funksionimin e mekanizmave të unifikuar të monitorimit dhe raportimit sipas kërkesave të Strategjisë dhe sistemit SIPI/IPSIS;
- drejton Ekipin Tematik Antikorrupsion.

2) Ekipi Tematik Antikorrupsion

Ekipi Tematik Antikorrupsion⁵ është struktura ndërinstucionale që mbështet Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e tij si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Ekipi Tematik Antikorrupsion vepron si një mekanizëm koordinues dhe orientues, duke siguruar që angazhimet e parashikuara në Strategji dhe në Planin e Veprimit në zbatim të saj të zbatohen në mënyrë të unifikuar, të harmonizuar dhe të matshme nga të gjitha institucionet përgjegjëse. Ai është një organ kolegjal ndërinstucional që siguron bashkërendimin dhe koherencën në zbatimin dhe raportimin e masave kundër korrupsionit. Ekipi Tematik Antikorrupsion përbëhet nga përfaqësues të të gjitha ministrive të linjës⁶ dhe të autoriteteve publike me kompetenca kundër korrupsionit, si: ILDKPKI, KDIMDHP, KLSH dhe APP. Pjesë e takimeve të Ekipit Tematik

⁵ Urdhër i Kryeministrit , Nr. 90, datë 1.8.2023, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

⁶ Në referencë me pjesën IV: Zbatimi, llogaridhënia dhe koordinimi, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030 (faqe 65).

Antikorrupsion janë edhe përfaqësuesit e institucioneve zbatuese të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj.

Ekipi Tematik Antikorrupsion ka këto detyra:

- mbështet Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, në orientimin strategjik dhe politik të procesit të zbatimit të Strategjisë;
- harmonizon prioritetet dhe angazhimet ndërinstytucionale në kuadër të Strategjisë;
- shqyrton progresin e zbatimit të Strategjisë dhe raportet e monitorimit të saj;
- identifikon sfidat që ndikojnë në zbatimin e Strategjisë dhe propozon masa për përmirësim.

Ekipi Tematik Antikorrupsion mblidhet periodikisht, sipas një kalendari të përcaktuar nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe në mënyrë të jashtëzakonshme kur kërkohet trajtimi i çështjeve emergjente, që ndikojnë në zbatimin e Strategjisë. Procesverbalet, vendimmarrjet dhe rekomandimet e Ekipit Tematik Antikorrupsion dokumentohen dhe mbahen nga sekretariati teknik⁷ i tij për ndjekje të mëtejshme.

3) Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit është struktura teknike përgjegjëse për drejtimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë. Në cilësinë e sekretariatit teknik të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, ajo siguron funksionimin efektiv të mekanizmave të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të Strategjisë. Paralelisht, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ushtron rolin e sekretariatit teknik⁸ të Ekipit Tematik Antikorrupsion, duke garantuar koordinimin dhe menaxhimin e integruar sektorial dhe ndërsektorial të politikave kundër korrupsionit.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit koordinon punën e institucioneve zbatuese të Strategjisë dhe ndjek zbatimin e angazhimeve të parashikuara në Planin e Veprimit dhe në Pasaportën e Treguesve të Performancës. Për këtë qëllim, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit përgatit dhe shpërndan udhëzime praktike për punonjësit përgjegjës, ofron orientime tematike dhe mbështetje operationale gjatë procesit të raportimit dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e të dhënave dhe progresin e zbatimit të Strategjisë.

⁷ Këtë funksion e kryen Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

⁸ Në përputhje me parashikimin e pikës 15 të urdhrit Nr.90, datë 1.8.2023:

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit monitoron zbatimin e Strategjisë përmes njësisë përgjegjëse⁹ për monitorimin, e organizuar në nivel sektori. Kjo njësi ndjek zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion dhe arritjen e vlerave të treguesve të performancës, duke mbledhur, përpunuar, vlerësuar dhe analizuar të dhënat e raportuara nga institucionet zbatuese.

Në kuadër të funksioneve të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit:

- koordinon punën e institucioneve zbatuese gjatë planifikimit, zbatimit dhe raportimit të Strategjisë;
- ndjek progresin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve dhe analizon vlerat e treguesve të performancës;
- përgatit raportet periodike monitorimi mbi zbatimin e Strategjisë;
- informon përmes raporteve Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Ekipin Tematik Antikorrupsion mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë;
- mbështet dhe udhëzon Pikat e Kontaktit Antikorrupsion gjatë procesit të raportimit dhe monitorimit të Strategjisë.

4) Institucionet zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

Institucionet zbatuese të Strategjisë luajnë një rol kyç në zbatimin e kuadrit strategjik. Ato planifikojnë, organizojnë dhe zbatojnë në praktikë angazhimet e parashikuara në Planin e Veprimit duke ndjekur objektivat e Strategjisë. Për këtë qëllim, institucionet zbatuese identifikojnë dhe angazhojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare dhe bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe me institucione të tjera me kompetenca kundër korrupsionit. Në varësi të angazhimeve të caktuara, institucionet zbatuese veprojnë si institucione udhëheqëse dhe/ose kontribuese në zbatim të Strategjisë.

Institucionet zbatuese e kryejnë rolin e tyre duke:

- hartuar dhe zbatuar Planin e Zbatimit të Strategjisë, në përputhje me orientimet metodologjike të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit ;
- siguruar burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe logjistike për zbatimin e angazhimeve;
- bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit gjatë fazave të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të Strategjisë;
- identifikuar në kohë problematikat dhe vonesat e mundshme në zbatim;
- marrë masave korrigjuese përkatëse për adresimin e tyre.

⁹ Sektori i Monitorimit dhe Koordinimit të Politikave Prioritare, si pjesë e Drejtorisë së Zbatimit të Politikave Antikorrupsion në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, të miratuar me urdhër nr. 146, datë 1.8.2024, të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit".

Institucionet zbatuese veprojnë përmes strukturave dhe mekanizmave të përcaktuar për koordinim teknik dhe raportim, kryesisht përmes Pikave të Kontaktit Antikorrupsion dhe Ekipit Tematik Antikorrupsion. Struktura të tjera teknike brenda institucioneve me përgjegjësi të posaçme, kontribuojnë gjithashtu në këtë proces në rol mbështetës.

4.1 Pikat e Kontaktit Antikorrupsion

Pikat e Kontaktit Antikorrupsion janë punonjës të caktuar nga titullari i institucionit zbatues të Strategjisë të cilët ndjekin dhe monitorojnë zbatimin e angazhimeve të institucionit në Strategji dhe në Planin e Veprimit Antikorrupsion si dhe raportojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Pikat e Kontaktit Antikorrupsion:

- planifikojnë zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit;
- administrojnë dhe konsolidojnë të dhënat për zbatimin e Strategjisë;
- bashkërendojnë punën brenda institucionit me strukturat e tjera të përfshira, si:
 - burimet njerëzore;
 - autoritetin përgjegjës për konfliktin e interesit;
 - njësitë e sinjalizimit;
 - auditin e brendshëm;
 - koordinatorët e etikës;
 - koordinatorin e të drejtës së informimit.
- bashkëpunojnë me strukturat tekniko-profesionale të institucionit për çështje të raportimit, monitorimit dhe informimit të brendshëm;
- ndjekin zbatimin në kohë të masave dhe aktiviteteve, duke monitoruar afatet dhe burimet e nevojshme;
- raportojnë periodikisht pranë njësisë së monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Rol teknik	interpretajnë saktë kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga Strategjia; bashkëpunojnë me strukturat e brendshme të institucionit në fushat e etikës, konfliktit të interesit, sinjalizimit, transparencës, integritetit dhe auditimit të brendshëm; kontribuojnë në sigurimin e cilësisë dhe saktësisë së të dhënave dhe dokumentacionit mbështetës që përdoret për monitorim dhe raportim.
Rol raportues dhe monitorues	marrin pjesë në mbledhjet e Ekipit Tematik Teknik Antikorrupsion; diskutojnë progresin e zbatimit, të dhënat e raportuara dhe problematika të institucionit që përfaqësojnë; hartojnë dhe miratojnë raportet e monitorimit në nivel teknik;

<p>Rol informues dhe këshillues brenda institucionit</p>	<p>informojnë titullarët e institucionit të tyre mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë; evidentojnë dhe raportojnë nevojat për mbështetje shtesë; përcjellin dhe shpjegojnë rekomandimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit; propozojnë masa institucionale për përmirësimin dhe garantimin e zbatimit cilësor të Strategjisë.</p>
---	---

4.2 Ekipi Tematik Teknik Antikorrupsion

Ekipi Tematik Teknik Antikorrupsion është një strukturë ndërinstytucionale, e përbërë nga Pikat e Kontaktit Antikorrupsion të institucioneve zbatuese të Strategjisë. Ky organ vepron në nivel teknik dhe shërben si mekanizmi kryesor i koordinimit të përditshëm për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e Strategjisë.

Roli i Ekipit Tematik Teknik Antikorrupsion është të bashkërendojë punën ndërmjet institucioneve zbatuese, përpara se dokumentet dhe raportet e vlerësimit t'i paraqiten Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Në këtë cilësi, Ekipit Tematik Teknik Antikorrupsion funksionon si strukturë teknike bashkëpunuese me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe kryen këto detyra:

- mblidhet periodikisht, me thirrjen dhe nën drejtimin e njësisë së monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, për të shqyrtuar dhe miratuar raportet e monitorimit;
- diskuton mbi ecurinë e zbatimit, sfidat, problematikat dhe propozon masat korrigjuese, përpara se ato t'i paraqiten Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit;
- vepron si urë lidhëse midis Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe institucioneve zbatuese, duke ndihmuar në sqarimin e paqartësive, koordinimin e afateve dhe adresimin e nevojave të tjera teknike.

4.3 Strukturat e brendshme tekniko-profesionale të institucioneve zbatuese të Strategjisë

Pikat e Kontaktit Antikorrupsion bashkëpunojnë ngushtë me strukturat e brendshme tekniko-profesionale të institucioneve zbatuese. Këto struktura mbështesin drejtpërdrejt zbatimin, monitorimin dhe raportimin e masave dhe aktiviteteve të Strategjisë duke kontribuar në


funksionimin efektiv të instrumenteve të integritetit dhe në përmbushjen e objektivave dhe angazhimeve të Strategjisë.

Këto struktura përfshijnë:

- ❖ Koordinatorët Kundër Korrupsionit¹⁰, si pjesë e stafit të lidhur me funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;
- ❖ Koordinatorët e Integritetit, përgjegjës për zbatimin e Planeve Institucionale të Integritetit;
- ❖ Nëpunësit në Njësitë e Burimeve Njerëzore që mbulojnë çështjet e etikës, në lidhje me funksionet e Departamentit të Administratës Publike;
- ❖ Autoriteti Përgjegjës për konfliktin e interesit pranë institucioneve, në lidhje funksionale me ILDKPKI;
- ❖ Njësitë e Brendshme të Sinjalizimit, në lidhje funksionale me ILDKPKI;
- ❖ Koordinatorët për të Drejtën e Informimit, në lidhje funksionale me KDIMDHP; dhe
- ❖ Njësitë e Auditit të Brendshëm në institucionet publike, në lidhje funksionale me Ministrinë e Financave.

Figura më poshtë paraqet skemën e institucioneve dhe autoriteteve përgjegjëse për zbatimin, monitorimin, raportimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit:

Figura 1: Autoritete me kompetenca dhe funksione në zbatimin e SNKK



¹⁰ Këta janë persona të caktuar në institucione në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 436, datë 26.6.2024.

II. ZBATIMI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Zbatimi i Strategjisë bazohet në një proces të qartë dhe të koordinuar pune. Ky proces u mundëson institucioneve zbatuese të kuptojnë qartë angazhimet që kanë, hapat konkretë që duhet të ndërmarrin dhe procedurat që duhet të ndjekin gjatë zbatimit.

Kjo pjesë e Manualit ofron udhëzime praktike për planifikimin, zbatimin dhe raportimin e Planit të Veprimit të Strategjisë në përputhje me parimet dhe metodologjinë e përcaktuar për kuadrin strategjik.¹¹ Institucionet zbatuese¹² i kthejnë angazhimet e Strategjisë në rezultate konkrete përmes planifikimit të mirë vjetor, bashkërendimi me strukturat përgjegjëse antikorrupsion brenda institucionit dhe komunikimit të rregullt me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Zbatimi i Strategjisë nuk është vetëm një proces administrativ, por një proces i vazhdueshëm përmirësimi, ku angazhimi i institucioneve dhe koordinimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e rezultateve të qëndrueshme në parandalimin e korrupsionit.

Në vijim paraqiten elementët kryesorë të planifikimit të zbatimit të Strategjisë, si dhe hapat që institucionet duhet të ndjekin për të siguruar një zbatim të plotë dhe të koordinuar. Këto përfshijnë:

- (1)** Informimin dhe vënien në dijeni të institucioneve për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit;
- (2)** Identifikimin e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit dhe treguesve të performancës;
- (3)** Planifikimin e zbatimit në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit;
- (4)** Koordinimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në nivel institucional;
- (5)** Mbështetjen nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe institucionet zbatuese.

¹¹ Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit për periudhën aktuale të viteve 2024-2030, dhe paketa metodologjike e raportimit SIPI/IPSIS.

¹² Institucionet zbatuese të SNKK janë: Të gjitha ministritë e linjës, Ministra të Shtetit, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Kuvendi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, KDIMDHP, ASPA, AKSHI, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, ILDKPKI, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Departamenti i Administratës Publike, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Agjencia e Prokurimit Publik, Bashkitë, Qarqet, Inspektorati Qendror, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës, entet rregullatore, Policia e Shtetit, SPAK, Prokuroria e Përgjithshme, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Zyra e Rikuperimit të Aseteve, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, RTSH, Instituti i Statistikave.

1. Informimi dhe vënia në dijeni e institucioneve për miratimin e kuadrit strategjik kundër korrupsionit

Informimi dhe vënia në dijeni e institucioneve është hapi i parë që garanton fillimin e zbatimit të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj. Ky proces siguron që të gjitha institucionet me detyrime për zbatim në Strategji të jenë zyrtarisht të informuara për miratimin e saj të sigurojnë dokumentet përkatëse dhe të fillojnë planifikimin e veprimeve të nevojshme për zbatimin.

Me informim dhe vënie në dijeni do të kuptojmë:

- njoftimin zyrtar të institucioneve për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit;
- dërgimin e versionit elektronik dhe kur kërkohet, edhe të versionit fizik të dokumenteve në të gjitha institucionet me angazhime për zbatim në Strategji;
- sqarimi i rëndësisë së fillimit të menjëhershëm të zbatimit dhe të rolit që ka secili institucion në këtë proces.

Brenda 10 ditëve nga miratimi i Strategjisë, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në cilesinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit njofton zyrtarisht institucionet përgjegjëse për zbatimin e saj. Me këtë njoftim institucionet marrin paketën e plotë e cila përfshin Strategjinë, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve të Performancës, si dhe angazhohen për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj.

Në vijim të këtij njoftimi, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit informon drejtuesit e institucioneve dhe Pikat e Kontaktit Antikorrupsion të institucioneve zbatuese mbi detyrimet institucionale që rrjedhin nga Strategjia dhe Plani i Veprimit.

Në këtë fazë, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit kërkon nga çdo institucion zbatues caktimin dhe/ose rikonfirmimin e Pikës së Kontaktit Antikorrupsion, si strukturë teknike përgjegjëse për bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit përgjatë zbatimit të Strategjisë. Pas caktimit të Pikës së Kontaktit Antikorrupsion, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit koordinon procesin ndërinstitutional dhe ofron udhëzimet metodologjike planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e Strategjisë. Modelet standarde për planifikimin e zbatimit, monitorimit dhe formati i raportit janë pjesë përbërëse e këtij Manuali.

Ky hap siguron që, përpara nisjes së procesit të planifikimit dhe të zbatimit të Strategjisë, të gjitha institucionet të kenë të përcaktuar strukturën teknike përgjegjëse për ndjekjen e procesit brenda institucionit dhe për bashkëpunimin e rregullt me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit.



Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin nis komunikimin zyrtar për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit si dhe për fillimin e zbatimit të tyre.



Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit kërkon nga institucionet zbatuese përcaktimin ose rikonfirmimin e Pikave të Kontaktit Antikorrupsion si struktura teknike përgjegjëse për bashkëpunimin gjatë zbatimit të Strategjisë.

2. Identifikimi i masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit dhe treguesve të performancës

Përgatitja e procesit të zbatimit të Strategjisë nis me identifikimin e përmbajtjes së Planit të Veprimit, që çdo institucion do të kryejë gjatë periudhës raportuese. Në këtë fazë, institucionet zbatuese njihen me vlerat të synuara të treguesve të performancës, identifikojnë burimevet e nevojshme që do të përdoren dhe përcaktojnë nevojat për bashkëpunim ndër-institucional. Ky hap u mundëson institucioneve zbatuese të qartësojnë detyrimet, objektivat dhe mjetet për zbatimin e Strategjisë.

Dy muaj përpara fillimit të çdo periudhe raportimi, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit kërkon nga Pikat e Kontaktit Antikorrupsion të nisin përgatitjet për zbatimin e Planit të Veprimit në zbatim të Strategjisë. Pikat e Kontaktit Antikorrupsion duhet të:

- identifikojnë masat dhe aktivitetet e Planit të Veprimit për të cilat institucioni i tyre është përgjegjës si institucion udhëheqës dhe/ose kontributor, për periudhën raportuese;
- planifikojnë angazhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike për zbatimin e masave dhe aktiviteteve;
- koordinojnë të dhënat për vlerësimin e vlerave të synuara në Pasaportën e Treguesve të Performancës për periudhën raportuese;
- bashkëpunojnë me strukturat e brendshme përgjegjëse si: autoritetet përgjegjëse për konfliktin të interesit, të drejtën e informimit, etikën, integritetin, auditim e brendshëm, sinjalizimin e brendshëm;
- identifikojnë institucionet mbështetëse të parashikuara në Planin e Veprimit për secilin masë dhe aktivitet;
- parashikojnë sfidat e mundshme dhe përcaktojnë masa parandaluese.

Vëmendje:

Pikat e Kontaktit Antikorrupsion të identifikojnë saktë masat, aktivitetet dhe vlerat e treguesve që në këtë fazë për një zbatim të mirë të Strategjisë.

3. Planifikimi i zbatimit në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton planin e zbatimit të Strategjisë sipas formatit standard të përcaktuar në Aneksin 1 të këtij Manuali. Ky plan shërben si instrument pune për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit. Plani i zbatimit përfshin, ndër të tjera, këto elemente kryesore:

- ✓ titullin dhe përshkrimin e masës dhe të aktivitetit, sipas Planit të Veprimit;
- ✓ institucionin përgjegjës dhe institucionet kontribuese;
- ✓ burimet e nevojshme për zbatim (njerëzore, financiare dhe logjistike);
- ✓ objektivin që synohet të arrihet me zbatimin e masës dhe aktivitetit;
- ✓ qëllimin dhe fushën e ndërhyrjes;
- ✓ ekspertizën e kërkuar dhe institucionet mbështetëse;
- ✓ zyrtarët ndërlidhës përgjegjës për bashkëpunimin;
- ✓ sfidat e mundshme në zbatim;
- ✓ mjetet dhe masat për adresimin e këtyre sfidave.

Institucionet zbatuese dorëzojnë planifikimet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, konkretisht pranë njësisë përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Strategjisë, jo më vonë se një muaj përpara fillimit të periudhës raportuese. Institucionet përdorin formatin standard të përcaktuar në Aneksin 1 të këtij Manuali.

Pas marrjes së planifikimeve institucionale, Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit i vlerëson ato për cilësinë, realizueshmërinë dhe përputhjen e tyre me rezultatet e pritshme të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj.

Në këtë fazë, Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit verifikon këto elementë:

- nëse janë përfshirë të gjitha masat e aktivitetet respektive që i takojnë institucionit zbatues për atë periudhë raportimi;
- nëse planifikimet janë të plota dhe përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar sipas formatit bazë;
- nëse strukturat bashkëpunuese brenda institucionit janë identifikuar saktë dhe është caktuar roli i tyre;
- nëse rezultatet e pritshme janë specifikuar qartë dhe në përputhje me vlerat e synuara të treguesve të performancës;
- nëse institucioni ka burimet e mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të ndjekur zbatimin;

- nëse problematikat, sfidat e mundshme dhe nevojat për mbështetje janë adresuar mirë dhe në zbatim të objektivave të kuadrit strategjik.

Në rast se Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit evidenton mangësi ose mundësi për përmirësim në planifikimet institucionale, ajo kërkon nga Pikat e Kontaktit Antikorrupsion të kryejnë plotësimet e nevojshme brenda një afati të caktuar dhe ofron udhëzime konkrete për përmirësim. Pas përfundimit të rishikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit miraton Planet institucionale të Zbatimit.


Pas marrjes së Planeve përfundimtare institucionale të Zbatimit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit përgatit Planin e Përgjithshëm të Zbatimit për periudhën e ardhshme raportuese të Strategjisë dhe harton një kalendar të detajuar për zbatimin e masave dhe aktiviteteve. Në këtë kalendar Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit:

- përcakton radhën e veprimeve që planifikohen të kryhen, në funksion të produktit final (p.sh., përgatitja e një ligji kërkon: ngritja e një grupi pune, hartim analizë paraprake, konsultim, bashkërendim miratim në qeveri);
- shpërndan masat dhe aktivitetet në mënyrë të balancuar (për të shmangur mbingarkesën e institucioneve dhe për të siguruar garanci të qëndrueshme zbatimi);
- qartëson rolin e saj në zbatimin e masave dhe aktiviteteve ku kërkohet pjesëmarrja e saj.

Në përfundim, Planet përfundimtare institucionale të Zbatimit dërgohen zyrtarisht, pranë:

- drejtuesve të institucioneve zbatuese të Strategjisë,
- drejtuesve të institucioneve kontribuese të Strategjisë,
- Pikave të Kontaktit Antikorrupsion.

Pregatitja e Planit të Zbatimit të Strategjisë:



4. Koordinimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në nivel institucional

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit koordinon zbatimin e Strategjisë dhe ofron mbështetje teknike dhe organizative për Pikat e Kontaktit Antikorrupsion në institucionet zbatuese.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit e ushtron këtë rol përmes këtyre mekanizmave:

i) Mbështetje teknike dhe organizative për Pikat e Kontaktit Antikorrupsion

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit mban komunikim të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me Pikat e Kontaktit Antikorrupsion për të siguruar një proces të rregullt të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit lehtëson zbatimin e Strategjisë gjithashtu kur institucionet zbatuese kanë nevojë për asistencë teknike për kyerjen e masave dhe aktiviteteve. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit e realizon këtë duke:

- identifikuar sfidat dhe problematikat që mund të pengojnë në zbatimin e masave dhe të aktiviteteve;
- ndërmjetësuar komunikimin me institucionet e tjera kontribuese në zbatimin e masave dhe të aktiviteteve.

ii) Çaktimi i personave përgjegjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

Gjatë fazës së planifikimit dhe zbatimit të masave e aktiviteteve, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit cakton një person përgjegjës, pjesë e njësisë së monitorimit, për ndjekjen dhe monitorimin e procesit. Personi i kontaktit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit shërben si pikë referimi për sqarime teknike, ndjek ecurinë e zbatimit të masave dhe aktiviteteve dhe mbështet Pikat e Kontaktit Antikorrupsion në adresimin e çështjeve që lidhen me të gjitha fazat e zbatimit të Strategjisë.

iii) Ndërveprimi me institucionet me kompetenca antikorrupsioni (anëtarë të Ekipit Tematik Antikorrupsion)

Për masat dhe aktivitetet që kërkojnë angazhimin e institucioneve me fushë përgjegjësie specifike në luftën kundër korrupsionit si p.sh. ILDKPKI, KDIMDHP, DAP, KLSH, KQZ, etj., DPAK koordinon dhe krijon lehtësira për të:

- siguruar pjesëmarrjen e tyre në zbatimin e masave dhe aktiviteteve (kur është e nevojshme dhe përmenden edhe në Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë);
- përcaktuar rolet dhe kontributet e secilit institucion sipas kompetencave të tyre.



Punonjësit e njësive së monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit mund të kontaktohen dhe këshillohen për të rakorduar për zbatimin e angazhimeve institucionale të Strategjisë.

5. Mbështetje nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe institucionet zbatuese


Kur zbatimi i masave dhe aktiviteteve kërkon ekspertizë të specializuar Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit koordinon përfshirjen e institucioneve me kompetenca antikorrupsioni ose të institucioneve të tjera mbështetëse, në përputhje me përmbajtjen e Planit të Veprimit.

Për këtë qëllim, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit kërkon bashkëpunimin e institucioneve përkatëse për mundësinë dhe domosdoshmërinë e përfshirjes së tyre. Institucionet mbështetëse ofrojnë kontributin e tyre teknik në zbatimin e masave dhe aktiviteteve, në përputhje me kompetencat ligjore të fushës së tyre të veprimit.

Stafi përgjegjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit mban komunikimin dhe koordinimin me institucionet mbështetëse dhe institucionin zbatues, me qëllim zbatimin e masave dhe të aktiviteteve.

Figura më poshtë paraqet ciklin e plotë të veprimeve për zbatimin e Strategjisë:

Figura 2: Fazat e hartimit të planit të zbatimit të Strategjisë



III. MONITORIMI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë siguron llogaridhënie, transparencë dhe ndjekje të vazhdueshme të progresit të objektivave strategjike. Përmes monitorimit, institucionet analizojnë progresin e zbatimit, identifikojnë sfidat që ndikojnë në ecurinë e masave dhe propozojnë ndërhyrje korrigjuese në kohë, duke ndihmuar në rritjen e efektivitetit të masave të parashikuara për periudhën e zbatimit të Strategjisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit udhëheq procesin e monitorimit dhe siguron përdorimin e metodologjisë së monitorimit dhe sigurimin e koherencës së informacionit të mbledhur nga të gjithë institucionet zbatuese. Monitorimi zhvillohet në përputhje me Planin e Veprimit të Strategjisë dhe në zbatim të mekanizmave të Sistemit të Informacionit dhe Planifikimit të Integruar SIPI/IPSIS.

Institucionet zbatuese kontribuojnë në procesin e monitorimit përmes Pikave të Kontaktit Antikorrupsion, të cilat veprojnë si struktura koordinuese të brendshme për mbledhjen, verifikimin dhe përcjelljen e informacionit që lidhet me ecurinë e zbatimit të angazhimeve të Strategjisë.

Monitorimi synon të sigurojë një ndjekje të vazhdueshme të progresit të Strategjisë duke mundësuar vlerësim të bazuar në evidenca të plota, publike e të verifikueshme.

Në këtë kuadër, monitorimi:

- vlerëson në mënyrë të saktë, të matshëm dhe në kohë ecurinë e objektivave, masave e aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë si dhe të vlerave të synuara të treguesve të performances;
- forcon llogaridhënien institucionale përmes përdorimit të metodologjive dhe instrumenteve të unifikuara të monitorimit;
- identifikon sfidat, pengesat dhe faktorët që ndikojnë zbatimin dhe mundëson adresimin e tyre në kohën e duhur;
- mbështet orientimin e politikave dhe planifikimin e burimeve të nevojshme njerëzore, teknike dhe financiare.

Monitorimi i Strategjisë mbështetet në një grup parimesh themelore që sigurojnë objektivitet, koherencë dhe transparencë veprimesh. Më konkretisht, parime si:

Objektiviteti dhe paanshmëria: Monitorimi mbështetet vetëm në të dhëna të verifikueshme dhe informacione të dokumentuara duke shmangur vlerësimet subjektive apo të pabaza. Informacioni i mbledhur duhet të mbështetet vetëm mbi fakte dhe të dhëna të dokumentuara.

Transparenca dhe llogaridhënia: Institucionet zbatuese të Strategjisë, kontribuojnë me informacione dhe të dhëna mbi ecurinë e zbatimit, në komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe konkretisht me njësinë e monitorimit të saj. Të dhënat duhet të jenë të shkruara thjesht, qartë dhe të kuptueshme.

Standardizimi i formateve të monitorimit (anekset): Institucioneve zbatuese iu jepen për plotësim formate (anekse) në relevancë me përmbajtjen e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit dhe me vlerat e synuara të treguesve të performancës, me qëllim për t'i bërë të dhënat të krahasueshme dhe për të vlerësuar si duhet progresin e Strategjisë.

Koherenca institucionale: Monitorimi kryhet në mënyrë të koordinuar me institucionet përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, duke garantuar një qasje të harmonizuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Pikat e Kontaktit Antikorrupsion bashkëpunojnë me të gjitha drejtoritë brenda institucionit/ve të tyre për të mbledhur informacionin e duhur.

Evidenca e matshme: Masat, aktivitetet dhe të dhënat për treguesit e performancës vlerësohen mbi bazën produkti dhe të lidhur drejtpërdrejt me rezultatet e pritshme, p.sh., numër, përqindje, dokumente të hartuara, procedura të miratuara, takime.

Përmirësim i vazhdueshëm: Gjetjet e monitorimit përdoren për të orientuar ndërhyrjet e nevojshme dhe optimizimin e proceseve gjatë periudhës së zbatimit, identifikimin e problemeve dhe dhënien e rekomandimeve për zbatim.

Fazat nëpër të cilat kryhet monitorimi janë:

1. Organizimi i procesit të monitorimit

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë organizohet në mënyrë të strukturuar dhe të njëtrajtshme. Procesi zhvillohet dy herë në vit, përmes periudhave gjashtëmujore dhe rezulton në hartimin e dy raporteve të monitorimit për çdo vit kalendarik: i) raporti për gjashtëmujorin e parë të vitit dhe ii) raporti i plotë vjetor¹³. Këto dy raporte përbëjnë bazën për analizën e njëpasnjëshme të progresit, për harmonizimin e të dhënave ndër-institucionale dhe për vlerësimin e qëndrueshëm të zbatimit të Strategjisë.

¹³ Raport progresi (vit i plotë).

Procesi i monitorimit përfshin mbledhjen e informacionit për çdo objektiv të mbështetur në të dhënat për masat dhe aktivitetet e Planit të Veprimit e të vlerave të synuara të treguesve të performances. Monitorimi vjetor është një përmbledhje të gjetjeve të dy gjashtëmujorëve (vit i plotë), duke dhënë një pasqyrë të plotë të performancës së përgjithshme të zbatimit të kuadrit strategjik. Të dhënat e monitorimit shërbejnë gjithashtu për identifikimin e çështjeve që kërkojnë ndërhyrje në vijim.

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit drejton procesin e monitorimit, koordinon procesin me institucionet zbatuese, siguron zbatimin e standardeve të monitorimit dhe verifikon cilësinë e të dhënave të raportuara që bëhen pjesë e raportit/ve të monitorimit.

Pikat e Kontaktit Antikorrupsion mbledhin informacionin, sigurojnë evidencat dhe bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit për monitorimin.

Monitorimi mbështetet në formatet standarde të monitorimit, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij Manuali (shiko Aneks 2 e Aneks 3).

2. Si funksionon procesi i monitorimit?

Procesi i monitorimit zhvillohet njëkohësisht për të gjitha institucionet dhe ndjek disa hapa konkret.

Fillimisht, çdo institucion zbatues kryen masat dhe aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë dhe mbledh informacionin përkatës mbi to, afatet e zbatimit dhe evidencat që dokumentojnë përfundimin e tyre. Ky informacion mblidhet nga Pikat e Kontaktit Antikorrupsion.


Pas mbledhjes së informacionit, Pika e Kontaktit Antikorrupsion analizon të dhënat mbi baza produkti (masat dhe aktivitetet e Planit të Veprimit të Strategjisë). Mbledh dhe llogarit vlerën e synuar (gjashtëmujore dhe vjetore) të treguesve të performancës mbështetur në formulën llogaritëse dhe metodologjinë shpjeguese të Pasaportës së Treguesve të Strategjisë. Pasi informacioni mblidhet, të dhënat përgatiten sipas formateve standarde (Aneks 1 e Aneks 2), të cilat sigurojnë që të gjithë të raportojnë në të njëjtën mënyrë dhe dërgohen pranë njësisës së monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, institucionet zbatuese përgatisin të dhënat e tyre të monitorimit, dhe pas vlerësimit nga Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit përgatitet raportin gjashtëmujor të monitorimit.

Në fillim të çdo viti kalendarik pune, institucionet zbatuese përgatisin të dhënat e tyre të monitorimit për gjithë progresin e vitit të plotë. Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka

rolin e koordinimit teknik, verifikimit të cilësisë së informacionit dhe përgatitjes së raporteve përfundimtare të progresit të Strategjisë.

Ecuria e procesit të monitorimit, hapat dhe rolet e strukturave:



3. Roli i institucioneve dhe strukturave të përfshira në monitorim

Monitorimi i Strategjisë është një proces ku secili institucion përgjegjës, sipas rolit të ka në ndjekjen dhe zbatimin e saj, por edhe të strukturave të përfshira, ka një rol të qartë dhe konkret.

Më poshtë paraqiten funksionet praktike të secilit institucion të përfshirë në këtë proces:

Institucionet dhe strukturat	Roli dhe detyrat
DPAK	<ul style="list-style-type: none"> - shpjegon metodologjinë e monitorimit dhe formatet standarde të monitorimit që do të përdoren nga të gjitha institucionet; - shpjegon dhe sqaron çdo paqartësi lidhur me procesin e monitorimit dhe raportimit, kur institucionet kanë paqartësi; - mbledh informacionin e raportuar nga Pikat e Kontaktit Antikorrupsion; - kontrollon cilësisë e të dhënave dhe informacioneve të dërguara; - koordinon procesin ndërinstytucional të monitorimit, duke siguruar raportim të unifikuar; - përgatit raportet gjashtëmuajore dhe vjetore të zbatimit të Strategjisë; - ofron rekomandime për përmirësim për institucionet zbatuese.

<p>Institucionet zbatuese të Strategjisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - zbatojne Planin e Veprimit te Strategjise ne perputhje me objektivat dhe afatet; - sigurojne mbeshtetje administrative dhe burimet e nevojshme per realizimin e Planit te Veprimit te Strategjise; - adresojne gjetjet dhe rekomandimet e Drejtorise se Pergjithshme te Antikorrupsionit, permes masave korrigjuese konkrete; - caktojne dhe sigurojne funksionimin efektiv te Pikave te Kontaktit Antikorrupsion brenda institucionit.
<p>Pikat e Kontaktit Antikorrupsion</p>	<ul style="list-style-type: none"> - mbledhin të gjitha të dhënat e nevojshme për zbatimin e masave dhe aktiviteve të institucionit; - komunikojnë me strukturat bashkëpunuese brenda institucionit për informacionet që administrojnë ato; - verifikojnë saktësinë e informacionit të mbledhur; - plotësojnë formatet standarde të monitorimit (Aneksset 2 dhe 3 të këtij Manuali); - identifikojnë dhe raportojnë vështirësitë të hasura gjatë zbatimit; - komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme me DPAK.

4. Instrumentet që përdoren në monitorim

Procesi i monitorimit mbështetet në disa instrumente standarde që sigurojnë mbledhje dhe analizë të unifikuar të informacionit në të gjitha institucionet zbatuese.

Instrumentet bazë të monitorimit janë Plani i Veprimit në zbatim të Strategjisë dhe Pasaporta e Treguesve të Performancës. Këto dokumente përcaktojnë se çfarë matet për çdo objektiv të Strategjisë. Ato shërbejnë si udhërrëfyes për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Pikat e Kontaktit Antikorrupsion gjatë mbledhjes së të dhënave dhe vlerësimit të progresit.

Institucionet përdorin gjithashtu formatet standarde të monitorimit, të cilat garantojnë paraqitjen e informacionit në të njëjtin format. Këto formate përfshijnë të dhëna mbi progresin, periudhën e zbatimit, evidencat mbështetëse dhe sfidat e hasura.

Përdorimi i formateve standarde është i detyrueshëm siguron raportim të unifikuar, duke shmangur mospërputhjet në të dhënat e paraqitura. Formatet përkatëse janë pjesë përbërëse e këtij Manuali (Aneksset).

5. Afatet e monitorimit

Monitorimi i Strategjisë zhvillohet sipas një cikli vjetor, i ndarë në dy periudha raportuese. Institucionet zbatuese përgatisin dhe dorëzojnë të dhënat e monitorimit dy herë në vit, (1) në përfundim të gjashtëmujorit të parë, dhe (2) në përfundim të vitit kalendarik.

Afatet për dorëzimin e informacionit të monitorimit përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fillim të çdo viti dhe u komunikohen të gjitha institucioneve përmes komunikimeve me Pikat e Kontaktit Antikorrupsion. Në fund të çdo periudhe raportuese, Pikat e Kontaktit Antikorrupsion mbledhin, verifikojnë dhe plotësojnë të dhënat sipas formateve standarde dhe i dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar. Respektimi i afateve është thelbësor për zhvillimin në kohë të procesit të monitorimit dhe për përgatitjen e raporteve përkatëse.

Në bazë të informacionit të mbledhur, DPAK përgatit raportin gjashtëmujor dhe raportin vjetor të monitorimit. Raporti vjetor përmbledh të gjitha gjetjet kryesore të vitit, analizon progresin dhe përfshin rekomandime për përmirësim në ciklin pasues, duke mbështetur vendimmarrjen dhe ndjekjen e ecurisë së Strategjisë.



IV. RAPORTIMI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Raportimi i zbatimit të Strategjisë është pjesë përbërëse e procesit të monitorimit dhe shërben për vlerësimin e progresit, identifikimin e sfidave dhe orientimin e vendimmarrjes institucionale dhe ndërinstucionale.

Raportimi kryhet në përputhje me standardet e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS) dhe sipas formateve standarde të përgatitura nga njësia e monitorimit të Strategjisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, si pjesë përbërëse e këtij Manuali.

Në këtë kuadër, raportimi realizohet në nivele të ndryshme përgjegjësie, duke filluar nga institucionet zbatuese dhe nga vetë njësia e monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit.

1. Raportimi nga institucionet zbatuese

Institucionet zbatuese raportojnë në mënyrë periodike, gjashtëmujore dhe vjetore, mbi zbatimin e masave dhe aktiviteteve për të cilat janë përgjegjëse në Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë, të vlerave të synuara të treguesve të performancës (Pasaporta e Treguesve) duke përdorur formatet standarde të monitorimit të parashikuara në anekset e këtij Manuali, sikurse shpjeguar edhe në pjesën III.

Institucioneve zbatuese mund të kërkohet të dorëzojnë informacion të pjesshëm, raporte specifike, raporte të ndërmjetme ose të dhëna shtesë vetëm kur kërkohen nga:

- Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin/Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit,
- Ekipi Tematik Antikorrupsion,
- Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Këto raporte bëhen vetëm në rastet kur kërkohet informacion i menjëhershëm për çështje të rëndësishme, për përgatitjen e raporteve analitike, për procese vlerësimi apo për nevoja të posaçme të koordinimit strategjik.

Raportimi përfshin	Informacion mbi masat dhe aktivitetet; informacion përshkrimor të tyre dhe vlerat në numër/përqindje
	Informacion mbi vlerat e treguesit të performancës
	Vetë-vlerësimin e realizueshmërisë së objektivave të strategjisë
	Të dhëna mbi buxhetin e përdorur dhe burimet e financimit
	Sfidat kryesore të zbatimit e problematika, masat me performancë të dobët
Hapat për periudhën pasuese të zbatimit	

2. Raportimi nga Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit analizon raportet e institucioneve dhe përgatit raportet finale gjashtë mujore dhe vjetore të zbatimit të Strategjisë, në përputhje me standardet e SIPI/IPSIS.

Raportet kanë karakter analitik dhe jo thjesht statistikor, duke përfshirë një vlerësim të progresit dhe sfidave të zbatimit. Çdo raport përmban të paktën:

Raporti përfshin	Nivelin e realizimit të masave dhe aktiviteve dhe vlerat e treguesit të performancës (tabela përmbledhëse e masave dhe treguesve)
	Rezultatet e arritura kundrejt objektivave të strategjisë
	Vlerësimin e realizueshmërisë së objektivave të strategjisë (në %)
	Të dhëna mbi buxhetin e përdorur dhe burimet e financimit
	Sfidat kryesore të zbatimit e problematika, institucionet me performancë të dobët
Rekomandimet për përmirësim dhe hapat për periudhën pasuese të zbatimit	

3. Llojet e raporteve të zbatimit të kuadrit strategjik kundër korrupsionit


Raporti gjashtëmujor i zbatimit të Strategjisë

Raporti gjashtëmujor është instrumenti bazë i raportimit dhe përgatitet në përfundim të gjashtëmujorit të parë të vitit. Ai përmbledh ecurinë e masave dhe aktiviteve të parashikuara për këtë periudhë, duke përfshirë të dhënat për vlerat e synuara të treguesve të performancës (% dhe/apo në numër), arsyet e mosrealizimit, sfidat kryesore dhe masat e propozuara për

përmirësim. Ky raport është dokumenti kryesor mbi të cilin mbështetet DPAK për analizën e progresit dhe përgatitjen e raportimeve të Strategjisë.

Raporti vjetor i zbatimit të Strategjisë

Raporti vjetor përfshin raportin gjashtëmuor të parë, të dhënat për pjesën tjetër të vitit si dhe jep një vlerësim të plotë të zbatimit të Strategjisë në një vit të plotë kalendarik. Ai përmban analizën e përgjithshme të progresit vjetor, të dhënat kryesore të performancës institucionale, vlerësimin e rezultateve të arritura kundrejt objektivave strategjike dhe faktorëve që kanë ndikuar pozitivisht ose negativisht në zbatim. Raporti vjetor përfshin gjithashtu rekomandimet për orientimin e prioriteteve të vitit pasues dhe identifikon nevojën për ndërhyrje të reja politike, institucionale ose ligjore.




Në përfundim, raporti i monitorimit dërgohet për shqyrtim dhe vendimmarrje Ekipit Tematik Antikorrupsion nëpërmjet Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Raportet e pjesshme

Përveç raportimit periodik, institucioneve mund t'u kërkohet të dorëzojnë raporte të pjesshme ose tematike kur ka nevoja specifike analitike ose kërkesa urgjente të lidhura me çështje të caktuara të

Strategjisë. Këto raporte mund të kërkohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe/ose Ekipi Tematik Antikorrupsion për analiza të specializuara. Raportet e pjesshme, përdoren për verifikime të shpejta të ecurisë së një mase të veçantë, përgatitjen e raporteve ndërkombëtare të Shqipërisë për Komisionin Evropian, GRECO, OECD, UNCAC, etj., vendimmarrje apo procese rivlerësimi të Strategjisë ose Planit të Veprimit. Ato nuk kanë afate të rregullta, por prodhohen vetëm kur kërkohen dhe kur ka nevojë për informacion të saktë dhe të menjëhershëm.

Raporti i pjesshëm:



Raportet e pjesshme ose tematike kërkohen vetëm në raste të veçanta, pa afate të rregullta, për nevoja analitike, vendim-marrje ose raportim ndërkombëtar

V. ANEKSET: FORMATE STANDARD TË ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE TË RAPORTEVE TË MONITORIMIT

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit zbatohet përmes formateve zyrtare të dokumenteve të përdorura nga të gjitha institucionet gjatë planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit.

Modelet standard përfshijnë:

- **Aneks 1: Formati Standard i Planit të Zbatimit të Masave e Aktivitetit/ve**, i cili përcakton strukturën për planifikimin e detajuar të masave e aktiviteteve, afatet kohore, përgjegjësitë institucionale, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme.
- **Aneks 2: Formati Standard i Monitorimit të Masave dhe Aktivitetit/ve¹⁴**, që shërben për dokumentimin e progresit, realizimin e treguesve, sfidat e hasura dhe masat e ndërmarra për përmirësim.
- **Aneks 3: Formati Standard i Monitorimit të vlerave të synuara të Pasaportës së Treguesve të Performancës**, që përmban treguesit e matjes së rezultateve, burimet e verifikimit dhe metodologjinë përkatëse.
- **Aneks 4: Format Standard i Raportit të Monitorimit Gjashtëmuor e Vjetor**, që përmbledh ecurinë e përgjithshme të zbatimit të Strategjisë në nivel institucional dhe ndërinstitutional.

Këto modele janë pjesë integrale e këtij Manuali.

Aneks 1:

Formati Standard i Planit të Zbatimit të Masave e Aktivitetit/ve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe të Planit të Veprimit

Plani i zbatimit të masave e aktiviteteve për vitin _____

Model për Planin e Zbatimit të Masave dhe Aktivitetit/ve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit		
(1) Titulli/emërtimi i masës dhe të aktivitetit (si në Planin e Veprimit Antikorrupsion, përfshinë nr rendor)	(2) Institucioni përgjegjës	Emri i institucionit/eve të përcaktuara në Strategji si institucion udhëheqës
		Emri i institucionit/eve të përcaktuara në Strategji si institucione kontributorë
	(3)	Numri i personave të nevojshëm për zbatimin e aktivitetit

¹⁴ Në përputhje me parashikimet dhe angazhimet në Planin e Veprimit Antikorrupsion.

	Burimet e nevojshme për zbatim	Burimet financiare të nevojshme për zbatimin e aktivitetit
		Burimet teknike ose të tjera të nevojshme për zbatimin e aktivitetit
	(4) Objektivi për tu arritur	Përshkrimi i saktë i objektivit/ave që synohen të arrihen me zbatimin e masës dhe të aktiviteteve të planifikuara për to (mbi bazë produkti)
	(5) Qëllimi i masës dhe aktivitetit/ve	Të identifikohet fusha e ndërhyrjes (p.sh. Konflikti i Interesit, Sinjalizimi, Transparenca, etj.)
	(6) Ekspertiza e kërkuar për zbatim	Institucioni/et që do të ofrojnë ekspertizë ose bashkëpunim (ILDKPKI, KDIMDHP, DAP, KLSH, APP, etj.)
	(7) Zyrtarët ndërlidhës/ bashkëpunëtorë	Emri i njësisë/personit ndërlidhës/bashkëpunëtor (<i>liaison officer</i>) në institucionin zbatues që do të bashkëpunojë për zbatimin e tij
	(8) Sfida (pengesa) të mundshme	Lista e sfidave të mundshme që mund të ndikojnë në zbatimin e masës dhe aktivitetit/ve
	(9) Ekspertiza (mjete) për të përballuar sfidat	Mjetet (burimet) për tejkalimin e sfidave që mund të ndikojnë në zbatimin e masës dhe aktivitetit/ve

Pika e Kontaktit Antikorrupsion

Aneks 2:

Formati Standard i Monitorimit të Masave dhe Aktivitetit/ve të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

Kodi	Objektivat Strategjike dhe Institucionet Përgjegjëse Respektive	Periudha e zbatimit të Planit të Veprimit			Kosto indikative	Buxheti i planifikuar për vitin raportues		Buxheti i përdorur	Progresi deri më tani		Problematikat	Hapa të tjerë	Afati i përfundimit
		Fundi i vitit	Vlera e Targetit	/000 total	Totali në %	/000 total	Totali në %	Buxheti i përdorur deri më tani krahasuar me buxhetin indikativ (në %)	Jep me % zbatimin për çdo Qëllim Politike dhe Objektiv Specifik	I zbatuar Zbatuar pjesërisht I pazbatuar	(tekst)	(tekst)	(tekst)
	Buxheti total për strategjinë			Totali 1+2+3	100%								
(1) Titulli/ emërtimi i politikës (si në SNKK)													
(2) Titulli/emërtimi dhe Nr. i Objektivit Specifik (si në SNKK)													
(3)	(4)			(5)			(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	

Nr.rendor i masës (si në PV/SNKK)	Titulli/ emërtimi i masës (si në PV/SNKK)	Vlera e buxhetit (si në PV/SNKK)	Vlera e buxhetit të përdorur (si në PV/SNKK)	% e zbatimit	Zgjidh statusin e zbatimit (dhe jep info shpjeguese/të dhëna)	Përshkrimi i problemeve dhe sfidave	Përshkrimi i hapave të tjera për tu kryer	Vendos afatin e zbatimit (sin në PV/SNKK)
(12) Nr.rendor i aktivitetit (si në PV/SNKK)	(13) Titulli/ emërtimi i aktivitetit (si në PV/SNKK)							
	(14) Titulli/emërtimi i institucionit përgjegjës (si në PV)							
(15) Nr.rendor i aktivitetit (si në PV/SNKK)	(16) Titulli/ emërtimi i aktivitetit (si në PV/SNKK)							
	(17) Titulli/emërtimi i institucionit përgjegjës (si në PV)							
(18) Nr.rendor i masës (si në PV/SNKK)	(19) Titulli/ emërtimi i masës (si në PV/SNKK)							

<p>(20) Nr.rendori i aktivitetit (si në PV/</p>	<p>(21) Titulli/ emërtimi i aktivitetit (si në PV/SNKK)</p>
<p>(22) Titulli/emërtimi i institucionit përgjegjës (si në PV)</p>	
<p>(23) Titulli/ emërtimi i politikës (si në SNKK)</p>	
<p>(24) Titulli/emërtimi, dhe Nr. i Objektivit Specifik (si në SNKK)</p>	
<p>(25) Nr.rendori i masës (si në PV/SNKK)</p>	<p>(26) Titulli/ emërtimi i masës (si në PV/SNKK)</p>
<p>.....</p>	
<p>.....</p>	

Aneks 3:

Formati Standard i Monitorimit të Pasaportës së Treguesve të Performancës të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

Objektivi Specifik (vendos numrin dhe titullin e objektivit të Strategjisë)

Nr.	Objektivi Specifik	Treguesit e Performancës	Institucion përgjegjëse për mbledhjen e informacionit	Frekuenca e mbledhjes së të dhënave	Vlera bazë/Viti —	Vlera e synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti __)	Vlera arritur për periudhën raportuese (konkretisht viti __)	Realizimi i vlerës së synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti __)	Zbatimi i Objektivit Specifik ¹⁵	Probleme / çështje për tu shënuar	Hapat e rradhës
(1)	Nr. i Objektivit Specifik (si në SNKK)	(3)	(5)	(7)	(9)	(11)	(13)	(15)	(17)	(18)	(20)
		Titulli/emërtimi i treguesit të performancës (si në Pasaportën e Treguesve), përfshinë nr rendor)	Titulli/emërtimi i institucionit përgjegjës (si në Pasaportën e Treguesve)	6M & Vjetor	Vlera bazë (si në Pasaportën e Treguesve)	Vendosja e vlerës bazë për monitorimin sipas raportit të monitorimit të kaluar	Vendos të dhënat për vlerën e treguesit	Vendos matjen në përqindje të vlerës së treguesit			
		(4)	(6)	(8)	(10)	(12)	(14)	(16)		(19)	(21)
		Titulli/emërtimi i treguesit të performancës (si në Pasaportën e Treguesve), përfshinë nr rendor)	Titulli/emërtimi i institucionit përgjegjës (si në Pasaportën e Treguesve)	6M& Vjetor	Vlera bazë (si në Pasaportën e Treguesve)	Vendosja e vlerës bazë për monitorimin sipas raportit të monitorimit të kaluar)	Vendos të dhënat për vlerën e treguesit	Vendos matjen në përqindje të vlerës së treguesit		Përshkrimi i problemeve dhe sfidave	Përshkrimi i hapave të tjera për tu kryer

Informacion shtesë:

Arritje/mosarritje të sektorit gjatë vitit, që kanë ardhur si rezultat i realizimit/ mosrealizimit të treguesit,
Mënyra se si aktivitetet dhe masat kanë ndikuar/shpënë në realizimin/mosrealizimin e treguesit,
Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifik,

¹⁵ Sipas formulës
$$NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+TP4NR}{\text{Numri në i Treguesve të Performancës për objektivi}} \times 100\%$$

Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në parandalimin/goditjen/ndërgjegjësimin (sipas qasjes së treguesit/objektivit specifik),

Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në zbatimin e reformave kyç antikorrupsion/ mirëqeverisjes (SKZHI),

Aneks 4:

Formati Standard i Raportit të Monitorimit Gjashtëmujor dhe Vjetor Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

STRUKTURA E RAPORTIT TË MONITORIMIT

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT**
- II. PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT**
- III. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVËT SPECIFIKË, TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE MASAT**
- IV. PROGRESI LIDHUR ME OBJEKTIVËT, REZULTATET DHE IMPAKTIN**
- V. RISQET DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR**

ANEKSET

Ky raport përmban një pasqyrë të plotë të veprimtarisë së institucioneve zbatuese të SNKK dhe të Planit të Veprimit gjatë periudhës raportuese dhe hartohet në përputhje me metodologjinë e monitorimit dhe raportimit të SIPI/IPSIS.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmbledhja Ekzekutive shpjegon qëllimin e raportit, prezanton në mënyrë sintetike aktivitetet më të rëndësishme të periudhës, gjetjet dhe rekomandimet kryesore, si dhe jep një vlerësim të përgjithshëm mbi zbatimin e SNKK dhe të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit, sfida të zbatimit dhe përfundime të monitorimit.

I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT

Seksioni mbi **Informacionin Përmbledhës për SNKK dhe PV** jep të dhëna (statistikore dhe përshkrimore) mbi zbatimin e strategjisë dhe të Planit të Veprimit, progresin në numra dhe përqindje, metodologjinë e monitorimit, konsultimin e raportit.

II. PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT

Seksioni mbi **Progresin e Strategjisë** paraqet të dhëna statistikore dhe grafike për zbatimin e strategjisë dhe të masave të planit të veprimit, e të vlerave të synuara të treguesve të performancës duke evidentuar reforma të implementuara me sukses përgjatë periudhës, impaktin e implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritetit evropian, komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit dhe të dhëna mbi buxhetin e përdorur.

III. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË, TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE MASAT

Seksioni mbi **Progresin e Qëllimeve të Politikës** e objektivëve paraqet të dhëna të detajuara përcdo objektiv të strategjisë sipas planifikimit për periudhën që paraqet Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve të Performancës.

IV. PROGRESI LIDHUR ME OBJEKTIVAT, REZULTATET DHE IMPAKTIN

Seksioni mbi **Progresin e Rezultateve** të objektivëve paraqet impaktin dhe rezultatet e prekshme të zbatimit të strategjisë, duke evidentuar historitë e suksesit, vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit dhe konkluzionet e rekomandime.

V. RISQET DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

Seksioni mbi **Risqet dhe Hapat e tjera** evidenton vlerësimin e riskut duke përdorur dhe treguesit e matur dhe hapat e ardhshme për tu kryer.